



Prishtinë, 24.06.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1537_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2297_04_22** i dt.04.04.2022;
- Ankesa e konsumatorit e datës 28.04.2022

në seancën e mbajtur më datë 24.06.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Z.F nga komuna e Prishtinës.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2297_04_22, i datës 04.04.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 04.04.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2297_04_22 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit dhe ka obliguar KESCO-n që ti ofroj konsumatorit kontratë pagese 4 mujore për korrigjimin plotësues nr. 97769DPR-90140320 datë 28.05.2021.

E pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatorja Z.F brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRrE-së, duke parashtruar disa kërkesa:

- Ri-kalibrimi i shpenzimeve të bëhet në përputhje me mesataren e muajve Mars 2020, Prill 2020 dhe Dhjetor 2020.
- Mesatarja e shpenzimeve në këtë rast është 177 euro për muaj (pra nëse mirret për bazë muaji Mars, Prill dhe Dhjetor 2020 kur njehsori është konstatuar se është në rregull) që në këtë rast do të thotë borxhi i mbetur nga ana e palës të jetë 711.74 euro.
- Pagesa të jetë e mundur të paguhet më këste për 7 muaj.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

ZRrE, ka shqyrtuar një nga një të gjitha provat dhe dokumentet e tjera relevante si: Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0029151 datë 06.11.2020; Protokollin i shqyrtimit të



njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 5640 datë 21.04.2021; Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 25.06.2021; Përgjigja e KESCO-s e datës 18.06.2021; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 16.07.2021; Vendimi i DMK-së ZRrE/DMK_V_2297_04_22, i datës 04.04.2022 dhe Ankesa e konsumatorit e datës 28.04.2022, dhe gjeti se Vendimi i DMK-së është vendim i bazuar në prova e akte konkrete dhe si i tillë mbetet i pakontestueshëm në aspektin e ligjshmërisë.

Në një vështrim të përgjithshëm të rastit, ZRrE, ka vërejtur se fillimisht, me datë 10.06.2020 konsumatori bazuar në rregullat dhe procedurat në fuqi ka bërë kërkesë për zëvendësim-kalibrim-shqyrtim njehsori. Me datë 06.11.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 20027236, dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 75484393 me gjendje TL=000000 kËh dhe TU=000000 kËh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar te dhënat teknike te pikës matëse si dhe kanë evidentuar se nuk punon Display. Më tutje, me datë 21.04.2021 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes të njehsorit elektrik nr. 20027236 ku nuk është evidentuar gjendja e shpenzimeve si dhe kanë konstatuar se: njehsori elektrik nuk është në rregull, njehsori elektrik bllombat (vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime nuk ka si dhe kanë evidentuar si vërejtje që njehsori elektrik nuk ndizet. Ndërsa, Departamenti i faturimit në KESCO me datë 28.05.2021 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim plotësues nr. 97769DPR-90140320 në vlerë financiare **1,036.83€** duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 07/2020 deri 14 ditë të periudhës 11/2020. Me datë 25.06.2021 Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimin plotësuese nr. 97769DPR-90140320 datë 28.05.2021. Me datë 07.07.2021 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe procesverbalin e shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 5640 datë 21.04.2021. I pakënaqur me këtë përgjigje, me datë 16.07.2021 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti shqyrtohet korrigjimi plotësuese nr. 97769DPR-90140320 datë 28.05.2021. DMK me vendimin ZRrE/DMK_V_2297_04_22, i datës 04.04.2022 e refuzon ankesën e palës dhe në këtë rast pala parashtron ankesë në Bord të ZRRE-së. Bordi, pas analizimit të rastit në detaje, bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike, listave të leximit si dhe protokollit të shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 5640 datë 21.04.2021 konstaton se konsumatori nuk është faturuar për shpenzimet reale mujore për shkak të defekteve në njehsorë.

ZRrE e ka analizuar edhe rrjedhën e energjisë elektrike dhe ka gjetur se, Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik si dhe njehsorin e ri elektrik konstatohet se tek konsumatori lexuesi në shumicën e periudhave ka evidentuar se nuk mund të bëhet leximi i shpenzimeve mujore po ashtu ka evidentuar se mungojnë bllombat. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike vërtetohet se konsumatori nga periudha 06/2019 kur edhe është vendosur për matje njehsori elektrik nr. 20027236 deri me ndërrimin e njehsorit datë 06.11.2020 në periudha të ndryshme është faturuar pa matje në mënyrë të vlerësuar.

Bordi ka shqyrtuar edhe korrigjimin plotësues të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar konform Kodit të matjes të OSSH-së, përkatësisht nenit 4.11 i cili përcakton mënyrën e korrigjimit në rastet kur njehsori elektrik është teknikisht jo në rregull.



Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit Z.F dhe
- Arkivit të ZRRE-së.